



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
SEKRETARIATI

Nr Prot 4203

Pogradec, më 13.10.2023

Njoftim për konsultim publik

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË KONSULTIMIT PUBLIK, PËR PROJEKT VENDIMIN:

PËR

- **MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES NË PËRDORIM, PËR NDERTIM AEROGJENERATORE, FOTOVOLTAIKE (STACIONET, BAZAMENTET DHE OBJEKTET PERKATESE), NË PASURINE ME SIPËRFAQE TOTALE 13 HA e 2500M (TREMBEDHJETE HA E DYMIJË E PËSËQIND M).**

Propozuesi : *Bashkia Pogradec.*

- **Sqarime për projekt-aktin:** *Nga Bashkia Pogradec është parqitur për shqyrtim 1 projekt vendim për miratimin në parim të dhënies në përdorim, për ndertim aerogjeneratore, fotovoltaike (stacionet, bazamentet dhe objektet perkatese), në pasurine me sipërfaqe totale 13 ha e 2500m (trembedhjete ha e dymijë e pësëqind m) .Hartat treguese dhe relacioni bashkangjitur këtij projekt njoftimi.*

Kalendari i konsultimit : *Aktivitetet organizohen sipas kalendarit të konsultimit publik bashkangjitur këtij njoftimi*

Pjesëmarrës nga ana e Këshillit të Bashkisë :

- | | |
|--------------------|---------|
| a. Mimoza Shuli | Kryetar |
| b. Ahmed Guxholli | Anëtare |
| c. Klajdi Gjona | Anëtar |
| d. Klea Topa | Anëtare |
| e. Ylli Kasmollari | Anëtar |
| f. Jona Bojko | Anëtare |
| g. Matilda Tollaku | Anëtare |
| h. Nexhmi Torra | Anëtar |

Format e konsultimit :

- **Konsultim me takime fizike.**
- **Vjelje mendimi nëpërmjet postës dhe postës elektronike.**

Qëllimi i këshillimit publik

Duke qënë se në Projekt Vendimin e paraqitur nga administrata kërkohet

	<p><i>miratimi në parim i dhënies në përdorim për ndërtim aerogjeneratorët, fotovoltaike në pasurinë me sipërfaqe totale 13.2500 ha Këshilli Bashkiak është i interesuar të marrë mendimet e banorëve të Njesisë Administrative Cërravë nëse janë dakort për ndërtimin e gjeneratorëve fotovoltaikë.</i></p> <p><i>Nëse këto aerogjeneratorë fotovoltaikë ndërtohen do të thotë që do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik të të gjithë rajonit .Kështu, Këshilli i Bashkisë kërkon mendime dhe sygjerime si më poshtë:</i></p> <p><i>1. A është komuniteti dakort dhe a janë të gjitha sipërfaqet në pronësi shtet ?</i></p> <p><i>Për të sqaruar këtë pyetje Këshilli fton të gjithë komunitetin të japin mendime dhe sygjerime me qëllim që çdo vendimarrje të jetë e dakortësuar dhe e favorshme për të gjitha grupet e interesit.</i></p>
<p>Përshkrimi i çështjes që trajton projekt-akti</p>	<p>- <i>Projekt vendimi i propozuar kërkon që Këshilli i Bashkisë të marrë vendim për miratimin në parim të dhënies në përdorim, për ndërtim aerogjeneratorë, fotovoltaike (stacionet, bazamentet dhe objektet perkatese), në pasurine me sipërfaqe totale 13 ha e 2500m (trembedhjetë ha e dymijë e pësëqind m)</i></p>
<p>Pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut</p>	<p><i>Me qëllim për të orientuar (por jo kufizuar) mendimet dhe sygjerimet tuaja, këshilli ngre për ju disa pyetje për të dhënë mendime në mënyrë që të jetë sa më i qartë sygjerimi juaj dhe rrjedhimisht vendimarrja e Këshillit.</i></p> <p>- <i>A jeni dakort qe këto sipërfaqe të përdoren për interes publik?</i></p> <p><i>Çdo sygjerim tjetër është i mirëpritur.</i></p>
<p>Detaje të çdo takimi publik apo dëgjese publike që do të organizohet në lidhje me projekt-aktet për këshillim;</p>	<p>- <i>Takimet fizike do të realizohen në fshatin Blacë sipas kalendarit bashkangjitur për grupet e interesit duke përshtatur oraret për të siguruar pjesëmarrjen e grupeve të interesit pa penguar zhvillimin e aktivitetit të tyre normal.</i></p> <p>- <i>Sygjerimet mund të dërgohen edhe me postë në adresën: Bashkia Pogradec, Bulevardi Rreshit Çollaku, Lagj. 2, Pogradec ose në adresën elektronike keshilibashkiakpogradec@gmail.com</i></p>
<p>Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve,</p>	<p><i>Në pamundësi për të marrë pjesë në takimet fizike cdo banor, ose grup interesi mund të dërgojë sygjerimet e tij në postë në adresën: Bashkia Pogradec, Bulevardi Rreshit Çollaku, lagj. 2, Pogradec ose në adresën</i></p>

vërejtjeve;	<i>elektronike keshilibashkiakpogradec@gmail.com, deri në datën 01.11.2023</i>
Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, studime apo materiale me informacion në lidhje me çështjen që konsultohet	Bashkangjitur gjeni: <ul style="list-style-type: none"> - Projekt Vendimin e paraqitur. - Relacionet - Skicat
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmerren Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	<i>Këshilli i Bashkisë do të trajtojë me kujdes dhe seriozitet çdo sygjërim tuajin. Procesi i marrjes së mendimeve dhe sygjërimeve do të koordinohet nga sekretariati i këshillit dhe konkretisht:</i> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Për çdo takim fizik do të mbahen proces verbalët me të gjitha sygjërimet dhe proces verbali do behet publik.</i> - <i>Do hartohet raporti përmbledhës me gjithë rekomandimet e marra nga takimi. Raporti do publikohet.</i> - <i>Rekomandimet do t' dërgohen Kryetarit të Bashkisë për të dhënë mendimin e tij.</i> - <i>Përmbledhja e rekomandimeve dhe mendimet e Kryetarit të Bashkisë do paraqiten komisionit të Këshillit për ekonominë. (do publikohet).</i> - <i>Komisioni do shqyrtojë çdo sygjërim dhe mendim të kryetarit dhe do ti propozojë Këshillit çdo rekomandim (do publikohet).</i> - <i>Vendimarrja e Këshillit për këtë çështje do zhvillohet publikë, on-line dhe vendimarrja do publikohet.</i>
Data e publikimit	<i>Datë 13/10/2023</i>

SEKRETARE E KËSHILLIT

